



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NPT DAQA NEXHMEDIN SADIKU BI" të datës 26.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i kendeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunen e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-25-7023-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NPT DAQA NEXHMEDIN SADIKU BI" të datës 26.08.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i kendeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunen e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-25-7023-5-2-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NPT DAQA NEXHMEDIN SADIKU BI" (tutje "parashtruesi") me datë 22.08.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i kendeve te lodrave dhe fushave sportive ne komunen e Prishtines" me nr. të prokurimit 616-25-7023-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

“Në DT është kërkuar që ofertuesit të dorëzojnë mostrën për pozicionin 20 – “Uleşe Smart Solare”. Sipas specifikimeve teknike të parashtruara, kjo ulësë duhet të përmbajë:- Dimensione minimale: L:1700mm, B:565mm,H:800mm;- Strukturë metalike (këmbë, mbështetëse dhe pushimore për duar nga çeliku i mbuluar me pluhur);- Panel solar prej 80W;- Bateri Li-Ion 20Ah;- Dymbushëse wireless prej 15Wdhembushësetëshpejta;- Katër porta USB;- Sistem WIFI;- Sensorë për parashikimin e motit. Ky produkt është një ulësë inteligjente e gjeneratës së fundit, e cila nuk prodhohet aktualisht as në Kosovë por as në rajonin e Ballkanit dhe zakonisht importohet vetëm nga kompani të specializuara ndërkombëtare/evropiane. Për shkak të kompleksitetit dhe kostos së lartë të pajisjes (duke qenë e pajisur me panele solare, bateri, sensorë, sistem wireless dhe karikues modern), nuk është praktikisht e mundur të sigurohet si mostër fizike para hapjes së tenderit, pasi që ky kusht krijon vështirësi reale për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik vendas dhe rajonalë, duke reduktuar konkurrencën. Kërkesa për mostër fizike për këtë pozicion krijon një diskriminim territorial dhe material, pasi vetëm kompani nga jashtë Kosovës, të cilat tashmë kanë qasje direkte në furnitorë ndërkombëtarë, mund ta ofrojnë një pajisje të tillë si mostër para hapjes së ofertave. Përndryshe në kuptim të nenit 37 par. 1 të RRPP, edhe ashtu përcaktohet që AK duhet të shmangë kërkesat për mostra fizike përjashtimisht kur ato janë absolutisht të domosdoshme”.

Përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë shqyrtuar secila një nga një dhe me këtë rast është gjetur se dorëzimi i mostrës për të cilën bëhet fjalë është e nevojshme për të siguruar realizimin e këtij projekti në mënyrë efikase dhe efektive.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP.


Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.08.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.